

VASIL XHA – ADZM GJIROKASTËR

Drejtor i Administratës së Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë (ADZM Gjirokastrë).

Z. Vasil Xha mban pozicionin e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë që prej majit të vitit 2024. Vasil Xha ushtron detyrën e Drejtorit të Administratës Rajonale të Zonave të Mbrojtura Gjirokastrë që prej majit 2024.

Me formim në fushën e kontabilitetit dhe financës, z. Xha ka përfunduar studimet e larta pranë Universitetit “Eqerem Çabej” gjatë periudhës 2013–2023, ku është diplomuar në nivelet Bachelor, Master Profesional dhe Master Shkencor. Në vitin 2019 është diplomuar gjithashtu si Drejtor Sportiv pranë Federatës Shqiptare të Futbollit.

Karrierën profesionale e ka nisur në vitin 2016 si menaxher i licencuar nga FIFA. Gjatë periudhës 2020–2024 ka shërbyer si Inspektor pranë Inspektoratit Shtetëror Shëndetësor, Qarku Gjirokastrë, duke përfituar eksperiencë në fushën e inspektimit dhe administrimit institucional.

Z. Xha ka ndjekur trajnime të ndryshme brenda dhe jashtë vendit në fushën e mjedisit dhe mbrojtjes së natyrës, duke zgjeruar njohuritë dhe përvojën e tij në çështjet që lidhen me ruajtjen dhe menaxhimin e vlerave natyrore.